

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN QENDËR BILISHT**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Qendër Bilisht, me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifatat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë së komunës etj”. dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 171, datë 30.12.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 586/8, datë 30.12.2012, dërguar z. **Ramadan HOXHA**, Kryetar i Komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A.MASA ORGANIZATIVE**

1. Nga Komuna Qendër Bilisht, ti propozohet Këshillit të Komunës për miratim në strukturë të funksionit të juristit.

**Në mbledhjen më të parë**

2 Të merren masa, që hartimi i buxhetit të shoqërohet me një relacion shpjegues, ku të jenë analizuar hollësisht, objektivat që do të realizohen në kuadër të politikave të zhvillimit, rritja e të ardhurave për të krijuar mundësi më të mëdha për financimin e projekteve të ndryshme, rritja e shpenzimeve për investime duke i planifikuar të detajuara në nivel objekti etj.

**Menjëherë**

3. Të merren masa, për paraqitjen jo më pak se katër herë në vit para Këshillit të Komunës të raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuara të vitit ushtrimor.

**Menjëherë**

4. Gjatë kryerjes së inventarizimit të pasurisë së Komunës në fundin e Vitit 2012, të ngrihet komision me pjesëmarrjen e specialistëve të fushave të ndryshme, për rivlerësimin e objekteve si; godina e Komunës; shkollat, rrjeteve të ujësjellësit, rrugë, kanalizime. Ndërkohë të grupohen sipas llojeve të aktiveve. Në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” të ndryshuar dhe kërkesave që përcaktohen në Kap IV, pikat 73, 74 dhe 80, të UMF, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

**Menjëherë**

5. Të merren masa, nga ana e Njësisë së Prokurimit të Autoritetit Kontraktor, për inventarizimin në mënyrë të rregullt të dosjeve të prokurimeve dhe arkivimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Menjëherë dhe Vazhdimisht**

6. Të merren masa, nga ana e Autoritetit Kontraktor që për periudhën në vazhdim në prokurimet sipas procedurës me vlera të vogla, të mos kalohet kufiri ligjor i fondit limit si grup artikuj mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

**Vazhdimisht**

7. Të merren masa nga Zyra e Taksave për inventarizimin e dosjeve të subjekteve, vendosjen në to të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, të hapen dhe të mbahet në mënyrë elektronike regjistri i tatimpaguesve e regjistri për taksën e pastrimit dhe ndërtesave të popullatës.

**Menjëherë dhe Vazhdimisht**

8. Nga Zyra e Taksave të hartohet paketa e llojeve të gjobave, masat respektive të tyre, duke i propozuar Këshillit të Komunës, vendosjen e masës së gjobës për çdo shkelle të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) neni 6 të ligjit nr. 10.279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

**Menjëherë**

9. Ngarkohet Komuna që për ish nëpunësit e larguar nga puna të njoftoj Departamentin e Administratës Publike, në rastin kur mos ushtrimi i detyrës administrative nga ana e tyre, ka ndikuar në funksionimin administrativ të Komunës, mbështetur kjo në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.**

Nga Komuna Qendër Bilisht të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me vlerën **2,581,607 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. **Vlera 1,849,397 lekë**, për 17 subjekte ndërtuese të pajisur me Leje ndërtimi Formularin 4, si veprime në kundërshtim me UKM nr. 3, date 03.02.2010 "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010" dhe me nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.2008 "Për Urbanistikën" i ndryshuar.

**Menjëherë**

2. **Vlera 276,000 lekë**, për [REDAKTUAR], me detyrë Kryetari i Komunës, si pagesë më tepër limitit mujor të përcaktuar për telefoninë celulare, për vitet 2010, 2011 deri 30.09.2012. Në kundërshtim me VKM nr. 343, datë 11.7.2002 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publike", shfuqizuar me VKM. nr. 864, datë 23.7.2010.

**Menjëherë**

3. **Vlera 226,800 lekë**, e cila përfaqëson pagesën e shpërblimeve për 7 persona, në cilësinë e antarëve të Komisionit të Vlerësimit ofertave dhe Njësisë së Prokurimit, në kundërshtim me VKM nr 472, datë 02.07.2011 "Për disiplinimin e përdorimit e fondeve buxhetore, për vitin 2011" pika ç.

**Menjëherë**

4. **Vlera 145,410 lekë**, e cila përfaqëson klasifikimin e gabuar të operatorit fitues, në kundërshtim me nenin 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", në tenderin me objekt : *Ndërtimi i argjinaturës në lumin "Devoll" (Ura e fshatit "Tren" drejtimi Progri III-<sup>te</sup>)*. Në mënyrë solidare nga 3 anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

**Menjëherë**

5. **Vlerën 84,000 lekë**, e cila përfaqëson pagesa për udhëtim e dieta për 6 persona, në kundërshtim me pikën III/3/b të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit".

**Menjëherë**

### **C. MASA DISPLINORE**

- Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Kontratën individuale të punës dhe nenin 12 “Masa Disiplinore” të Rregullores së Brendshme të Komunës Qendër Bilisht, *kërkojmë nga Kryetari i Komunës*, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore si me poshtë:

#### **I. “Vërejtje me paralajmërim” , për:**

**1. [REDAKTUAR] me detyrë nën kryetar i Komunës dhe Përgjegjës i Shërbimeve në cilësinë e kryetarit të KVO dhe të anëtarit të Komisionit me blerje me vlera të vogla për gjithë periudhën e auditimit** për shkeljet në:

- Shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga autoriteti kontraktor për vitin 2011 dhe nëntëmujori i vitit 2012. *Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

- Shkelje të konstatuara në 22 procedurat e blerjeve me vlera të vogla 4 raste të kalimit të kufirit ligjor, vjetor prej 400 mijë lekësh për blerje të grup mallrash e grup shërbimesh për periudhën e auditimit. *Veprime këto në kundërshtim me germën “a” të pikës 2 të Kreut VI të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

**2. [REDAKTUAR] me detyrë përgjegjëse e Zyrës së Financës**, Për shkeljet në:

- Inventarizimin dhe gjendjen e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese si dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese. *Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 22 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë sektorit publik” kapitulli IV. - Për pagesën dhe furnizim e Kryetarit të Komunës për vitin 2012 me karta celulari, në kundërshtim me VKM nr. 343, datë 11.7.2002 pika 2 dhe VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë” pika 9 . - Për pagesat udhëtim e dieta në 3 raste në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” pika 3.1 dhe 3.2.*

**3. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Urbanistikës, në cilësinë e sekretarit të KRRT-së.**

-Për të meta në përlogaritjen e detyrimeve në lidhje me taksën e lejes së ndërtimit dhe pagesës së 1 për qind të preventivit për Studime Urbanistike në 17 raste për vitin 2010 dhe 2011. *Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, date 03.02.2010 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010” dhe nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.2008 “Për Urbanistikën” i ndryshuar.*

**4. [REDAKTUAR] me detyrë përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave**

-Për një punë të dobët në drejtimin e funksionimin e Zyrës së Taksa Tatimeve për gjithë periudhën e audituar, *në mos përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”.*

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Muhamet Kavaja, Irma Shkupi dhe Selman Hysaj. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Albert Thoma, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**